



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 20992 Prot

Tiranë, më 14.9.2018

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ✓

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Specialist** në Sektorin e kontrollit të deklarimeve CASH, në Drejtorinë e Antitrafikut, Kategoria C1, Kategoria e pagës III-b (1 vend)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
3. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
4. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
5. Të zotërojnë diplomë të nivelit të Lartë "Master Profesional" në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, Politeknike;
6. Të kenë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit;
7. Të ketë eksperiencë pune të paktën 1 (një) vit;
8. Të ketë njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;

9. Njohja e gjuhës angleze (gjuhë e dytë avantazh);
10. Pajisja me Certifikatë Sigurie nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përbën avantazh.

Përshkrim përgjithsues për pozicionin:

1. Regjistron, përpunon dhe analizon deklaratimet e parasë fizike në kufi dhe rastet e aktivitetit të dyshimtë në databazën përkatëse.
2. Ndërton dhe analizon profilet e riskut dhe raportet e nxjerra nga databaza e pastrimit të parasë dhe sistemi informatik i doganës.
3. Shkëmben informacione me drejtoritë dhe degët/pikat doganore për problemet e linjës.
4. Shkëmben informacion të klasifikuar/jo të klasifikuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe agjensitë e tjera të zbatimit të ligjit për linjën e PPP sipas akteve ligjore, nënligjore dhe përgatit dhe paraqet manuale, udhëzues mbi funksionimin dhe zbatimin e procedurave të linjës së PPP kur i kërkohet.
5. Informon Përgjegjësën e Sektorit dhe Drejtorin e Drejtorisë Antitrafik për ecurinë e linjës së PPP dhe ndihmon për propozime e nisma për trajnime e punën duke rritur efektivitetin.
6. Përdor dhe shfrytëzon maksimalisht akseset për të dhënat që i jepen nga institucione të tjera.
7. Mban kontakte me pikat e kontaktit në degët/pikat doganore kufitare në zbatim të akteve ligjore e administrative në fuqi.
8. Administron arshivën elektronike dhe dokumentare të linjës së PPP.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae (dhe letër motivimi);
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti (do të vihet në dispozicion nga Drejtoria e MBNJ pas plotësimit të formularit të vetdeklarimit);
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Raport mjeko-ligjor;
8. Fotokopje karte identiteti;
9. Fotokopje të librezës së punës;
10. Fotokopje të kurseve kualifikuese;
11. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 21.09.2018, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda Ikonomi

